



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivery	06-07-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOK	5080/2023		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.781/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.781/2023 të datës 26.05.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë rruga " [redacted] nga Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.781/2023 të datës 26.05.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted].

II. Mbetet në fuqi formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankueses [redacted] për vitin 2022 i datës 11.01.2023, për ankuesin [redacted].

A r s y e t i m a

Ankuesi [redacted] i, i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën *Zyrtar për Çështje Ekonomike në Agjencinë Pyjore të Kosovës*, më datë 26.05.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4480/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.06.2023, për mes e-mailit ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në

Agjencia Pyjore e Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 07.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4480/2023 e datës 26.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 13.05.2023; Kërkesë e datës 12.05.2023; Kërkesë e datës 27.03.2023; Ankesë me numër protokolli 352 e datës 30.01.2023; Njoftimi me numër protokolli 4394 i datës 10.10.2022; Deklaratë me numër protokolli 4169 e datës 26.09.2022; Kërkesë me numër protokolli 3756, e datës 25.08.2022; Vendimi A. Nr. 987/2023, i datës 20.12.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022; Përgjigje në shkresë e datës 05.01.2023; njoftimi i datës 22.08.2022; Përgjigje në shkresë e datës 05.01.2023; Referencë e datës 04.01.2023; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Akt Emërimi i datës 31.01.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 11.01.2023; Njoftimi i datës 09.12.2022, për Vlerësimin e Rezultateve në Punë; e- maili i datës 09.12.2022; Plotësim i lëndës për prova shtesë; Procesverbali i datës 13.08.2019; Vendimi i datës 27.04.2020; Procesverbali i datës 23.04.2020; Vendimi i datës 17.09.2019; Raporti mbi Vlerësimin e Aplikacioneve; Informate lidhur me përzgjedhjen për pozitën "Menaxher i Personelit"; e- maili i datës 26.05.2023; Shkresë e datës 10.01.2023, me numër protokolli 107/2023 ;Përgjigje në ankesë e datës 07.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit l... është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 pretendon që vlerësimi është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe provave të lëndës, konstaton se sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulet dhe Profesionale për vitin 2022, ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme 3.37 që nënkupton mirë.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 43 paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar që: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit",*



ndërsa neni 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)”*, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në kuadër të objektivave të përcaktuara.

Duke u bazuar në provat e lëndës si dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, del se ankuesi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është vlerësuar me notën e përgjithshme 3.37, që nënkupton se ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”;*, ndërsa në kuadër të kuptimit të notave sipas paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet që: *“mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës”*, bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, sepse meqë ankuesi është vlerësuar me mirë, rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit të njëjtës nuk i janë cenuar të drejtat për ngritje profesionale dhe ngritje në karrierë në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit sa i përket zbatimit të vendimit A. Nr. 987/2023 i datës 20.12.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kolegji konstaton se Agjencia Pyjore e Kosovës, për mes shkrese së datës 10.01.2023, me numër protokollit 107/2023, ka njoftuar Këshillin se ka zbatuar vendimit të Këshillit, me këtë rast Agjencia Pyjore e Kosovës, ka vepruar në pajtim me nenin 21, paragrafi 1,2 të Ligjit Nr. 06/1-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: **1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit, dhe mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara sa i përket zbatimit të vendimit A. Nr. 987/2023 i datës 20.12.2022.**

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi

1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.781/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

Ankuesit

Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Pyjore të Kosovës;

Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës; dhe

Arkivit të KPMSHCK-së.